

Material studimor për zhvillimin e njëjësive mësimore
 alternative në lëndën e historisë
 Libri i mësuesit
 (me materiale shtesë në CD)

SHQIPTARËT NË KAMPIN E PËRQENDRIMIT NAZIST MAUTHAUSEN, AUSTRI



Përgatiti: Prof. Asoc. Dr. Marenglen Kasmi

Përgatiti: Prof. Asoc. Dr. Marenglen KASMI

Në kopertinë:

Foto nga muzeumi në kampin Mauthausen, ku janë ekspozuar të burgosurit shqiptarë.

(Burimi: DMO Albania).

Ky material u prodhua në kuadër të projektit: “Historia e të mbijetuarve shqiptarë në kampin e përqendrimit Mauthausen”, ide e DMO Albania, në bashkëpunim me Muzeun Historik Kombëtar, financuar nga Evz Stiftung.

Faqja e projektit: www.remember.al



Copyright © DMO Albania
Të gjitha të drejtat të rezervuara.
Vetëm për përdorim mësimor në shkolla.

Tiranë 2022

Përmbajtja

Parathënie

Pushtimi gjerman i Shqipërisë 1943-1944

Arrestimet dhe deportimet në Mauthausen

GESTAPO [Geheime Staatspolizei – Policia e Fshehtë e Shtetit]

Shtojca 1: Zhvillimi i mësimit

Shtojcë 2: Anketë për mësuesit mbi temën e trajtuar

Shtojcë 3: Anketë për nxënësit mbi temën e trajtuar

Literatura

Parathënie

Lufta e Dytë Botërore përbën konfliktin më të madh dhe një nga faqet më të dhimbshme të historisë së njerëzimit në shekullin XX. Gjatë kësaj lufte u krijuan dy aleanca ushtarake, Fuqitë e Boshtit Qendror dhe Aleatët Perëndimorë. Në të u përfshinë në mënyrë direkte ose indirekte 60 shtete. Rreth 110 milionë njerëz u inkuadruan nën armë. Numri i viktimave shkon në varësi të burimeve historike që përdoren nga 50 deri në 70 milionë të vdekur. Ndër të tjera, Lufta e Dytë Botërore ka hyrë në histori si lufta në të cilën u zhvillua holokausti dhe u ngritën kampet e përqendrimit, u kryen shumë krime lufte, u përdor për herë të parë në masë strategjia e bombardimeve civile dhe ushtarake si edhe që u provuan pasojat fatale të armëve atomike.

Shqipëria ishte një ndër shtetet e para që ra pre e sulmit të Fuqive të Boshtit Qendror. Më 7 prill 1939 ajo u pushtua nga Italia fashiste dhe më 9 shtator 1943, pas kapitullimit të Italisë, Shqipëria u pushtua nga Gjermania naziste. Shqiptarët i pritën pushtuesit me armë dhe qëndresa ndaj tyre me kalimin e kohës u bë edhe më e organizuar, duke filluar nga qëndresa spontane dhe lëvizja guerile në fillimet e veta e deri në krijimin e Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, e cila në fund të luftës arriti në 70.000 luftëtarë partizanë.

Si pasojë e kësaj qëndresë edhe pushtuesit morën masa ndëshkuese kundër lëvizjes antifashiste, duke filluar prej arrestimeve, burgimeve, internimeve e vrasjeve. Jo rrallë këto masa ndëshkimore shoqëroheshin edhe me reprezalje në masë të gjerë ndaj popullsisë shqiptare.

Një nga ndëshkimet e ndërmarra nga pushtuesit gjermanë ishte edhe internimi i antifashistëve shqiptarë në kampet e përqendrimit. Të burgosurit shqiptarë vuajtën kryesisht në Kampin e Mauthausen-it. Sipas statistikave të memorialit të Kampit Mauthausen aty kanë vuajtur 161 persona nga Shqipëria ose me prejardhje shqiptare që u burgosën në Mauthausen ose nënkampet, 112 prej tyre vdiqën ose u vranë, 42 prej tyre mbijetuan dhe 7 prej tyre u transferuan nga Mauthausen ose nënkampet në kampe të tjera përqendrimi. Katër shqiptarë janë dokumentuar online në "dhoma e emrave", ku mund të gjenden fotografi të të burgosurve shqiptarë. Ata janë: Vangjel Shkurti (1884 – 1944) Xhemal Myhyrdari (1908 – 1945), Kozma Nushi (1909 – 1945), Xhevdet Doda (1906 – 1945).

Tema “Shqiptarët në kampet e përqendrimit gjatë Luftës së Dytë Botërore” nuk ka pasur ndonjë trajtim të gjerë në historiografinë shqiptare dhe aq më pak në tekstet mësimore shkollore. Por, duke pasur parasysh përmasat që po merr rritja e ekstremizmit të djathtë në Europë, trajtimi historik i sistemit Nationalsocialist të dhunës e krimeve në gjysmën e parë të shekullit XX, ku njëri nga mekanizmat e tij ishte edhe ngritja e kampeve të përqendrimit për eliminimin e kundërshtarëve politikë dhe racave të padëshiruara njerëzore si hebrenjtë, sllavët, njerëzit me ngjyrë etj., fiton një rëndësi të veçantë në edukimin e brezave të rinj.

Njësia mësimore është ndërtuar si më poshtë:

Janë hartuar dy njësi studimore, njëri për mësuesin dhe tjetri për nxënësin.

Në njësinë studimore të mësuesit jepet një pamje e përgjithshme e tematikës, duke filluar prej një përmbledhje mbi luftën e Dytë Botërore, pushtimin gjerman të Shqipërisë, organizimin e strukturave naziste sikurse ishte edhe Gestapo-ja, dhe në fund trajtohet çështja e shqiptarëve në kampin e përqendrimit Mauthausen. Njësia mësimore shoqërohet edhe me tre shtojca, ku jepen këshilla për zhvillimin e mësimit si edhe dy anketime, një për mësuesin dhe tjetri për nxënësin, të cilat zhvillohen në fund të mësimit. Më tej, dhënia e një panorame më të gjerë të ngjarjeve e zhvillimeve në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore i shërben formimit profesional historik të mësuesit. Ky informacion, i gërshetuar me trajtimet përkatëse në njësinë studimore për nxënësit, e plotëson më mirë kontekstin e zhvillimit të ngjarjeve dhe kuptimin e tyre.

Po ashtu, njësia studimore ka parashikuar edhe metodikën që do të ndiqet për zhvillimin e mësimit. Sigurisht që mësuesi është i lirë ta ndryshojë atë dhe ta përshtatë me kushtet aktuale ku zhvillohet mësimi.

Njësia shoqërohet edhe me një CD, në të cilën janë përzgjedhur materiale didaktike ndihmëse për zhvillimin e mësimit,

Pushtimi gjerman i Shqipërisë 1943-1944

Si pasojë e ndryshimit të situatës strategjike në detin Mesdhe, instancat drejtuese gjermane llogarisnin në fund të vitit 1942, si me një zbarkim të aleatëve në Ballkan ashtu edhe me kapitullimin e Italisë nga lufta. Vlerësimi i këtij realiteti mundësoi që, duke nisur prej fillimit të vitit 1943, Shqipëria të mos lihej më jashtë vëmendjes nga strukturat drejtuese gjermane.

Për rrjedhojë, qysh përpara se të ndodhte kapitullimi i Italisë, gjermanët dërguan trupa për ruajtjen e aerodromeve shqiptare. Po ashtu ata ishin të shqetësuar edhe nga rreziku i ndonjë zbarkimi të mundshëm të aleatëve në Shqipëri.

Urdhri përfundimtar për pushtimin e Shqipërisë u dha më 8 shtator 1943, menjëherë pas shpalljes së kapitullimit pa kushte të Italisë fashiste dhe ushtrisë së saj.

Si pasojë e rritjes së kërkesës së industrisë gjermane ndaj mineraleve nëntokësore me rëndësi strategjike si krom, naftë, magnez, linjit etj., Shqipëria fitoi një status të veçantë në këtë drejtim. Gjatë kohës së pushtimit Shqipëria siguroi 17% të nevojave gjermane për krom. Gjithashtu, ajo ishte, për nga prodhimi, në Evropën Juglindore, furnizuesi i dytë me naftë pas Rumanisë. Përveç furnizimit të Gjermanisë me minerale nëntokësore, Shqipëria financoi edhe mbajtjen e trupave gjermane dhe instancave të tjera të tyre, gjë që përbënte një ngarkesë shumë të madhe ekonomike për një vend të pazhvilluar. Shuma e parave e paguar nga shqiptarët për Wehrmacht-in gjatë pushtimit arriti afërsisht në 270 milionë franga. Gjithashtu u mor edhe gjithë ari shqiptar me një peshë prej afërsisht tre ton. Përfitimi ekonomik në lidhje me masat e tjera që u ndërморën prej gjermanëve, të cilat e shteronin fuqinë ekonomike të vendit, si largimi i popullsisë nga rajonet e begata të bregdetit dhe shkatërrimet e kryera gjatë masave ndëshkuese lanë pasoja të pandreqshme në ekonominë dhe jetën e shqiptarëve. Ato sollën inflacion, varfëri të tejskajshme të shumë shtresave të popullsisë dhe kriza buke.

Qëllimi i drejtuesve gjermanë ishte ruajtja e fuqisë luftarake e Wehrmacht-it, pra përdorimi i këtyre forcave ushtarake në fronte të tjera dhe, më tej, sigurimi i produkteve tepër të rëndësishme për luftën si krom, bakër, lëndë druri dhe ushqime. Duke u bazuar në këto dy arsye tepër të forta për zhvillimin e luftës, u arrit në konkluzionin që, qëllimet e mësipërme mund të arriheshin vetëm duke siguruar në Ballkan një “paqëtim” ushtarak dhe politik.

Një problem tjetër përbënte për Rajhun gjerman edhe mungesa forcave të mjaftueshme policore dhe ushtarake për një mision në Ballkan.

Synimi absolut i politikës gjermane ishte krijimi i një qeverie kompromisi dhe progjermane. Kjo qeveri duhej të kujdesej për mbarëvajtjen e qetësisë dhe rregullit në vend dhe më tej të merrte përsipër ruajtjen e rrugëve lidhëse të transportit. Në një plan të dytë, forcat ushtarake qeveritare duhej të ndihmonin Wehrmacht-in gjerman në ruajtjen e vijës bregdetare shqiptare. Për të arritur këtë qëllim mjaftonte që trupat qeveritare ti mbronin nga krahët forcat gjermane prej sulmeve partizane. Në shpërbllim të këtyre shërbimeve mund të njëhej pavarësia e shtetit shqiptar.

Për të arritur qëllimet e mësipërme ishte i nevojshëm bashkëpunimi ndërmjet palës ushtarake dhe diplomacisë, ku duhet theksuar që fillimisht diplomacia kishte prioritet.

Aparati pushtues gjerman në Shqipëri

Paralel me konsolidimin e një qeverie shqiptare pro gjermane u punua edhe për krijimin e një aparati pushtues gjerman. Hierarkia strukturore gjermane në Shqipëri ndahej në degë të veçanta dhe ishte komplikuar me postë të ndërtuara përkrah njëri-tjetrit. Rruga paralele që ndiqnin urdhrat politikë u standardizuan me krijimin e postit të „Të Dërguarit të Plotfuqishëm të Posaçëm për Europën Juglindore i Ministrisë së Jashtme“. Ky posti ishte tipik për sistemin Nationalsocialist. Vendimet e vështira që kërkonin një nivel të caktuar kompetence tashmë ju besuan të Dërguarit të Posaçëm.

¹ Shiko Marenglen Kasmi: Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane në shekullin XX (1900-1945), Tiranë 2020, (Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë) dhe Marenglen Kasmi: Pushtimi gjerman i Shqipërisë 1943-1944. Një këndvështrim në dritën e dokumenteve gjermane, Tiranë 2013.

Kreu i Ekzekutivit Ushtarak në Shqipëri ishte gjenerali komandues i Korpusit Malor XXI në Tiranë, i cili ishte në varësi të Komandës së Armatës së 2-të tankiste. Gjithashtu në direktivën e mësipërme ishte saktësuar që ushtrimi i masave ndëshkuese duhej të kryhej në bashkëpunim me të Dërguarin e Posaçëm. Edhe drejtuesit e lartë SS dhe të policisë, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre duhej të merrnin udhëzime në fushën politike nga Neubacher-i. Për tu theksuar është fakti që Wehrmacht-i, ndonëse ishte krijuar qeveria Mitrovica, formonte deri më 12 nëntor 1943 autoritetin më të lartë shtetëror. Ekzekutivi ishte ende në dorën e Komandës së Armatës së 2-të tankiste.

Më 3 tetor 1943 Hitler-i kishte urdhëruar krijimin e postit të “Gjeneralit të Plotfuqishëm Gjerman në Shqipëri”. Ky gjeneral kishte për detyrë të përfaqësonte interesat gjermane panë qeverisë shqiptare dhe të ushtronte gjithashtu detyrën e këshilltarit ushtarak. Në raste të veçanta ai kishte gjithashtu të drejta urdhëruese territoriale mbi të gjitha llojet e trupave gjermane në Shqipëri. Më tej ai kishte të drejtë që në situata kritike, si p.sh në luftë kundër partizanëve, të shpallte rajone të caktuara si rajone operacionale, ku do të zhvilloheshin veprime luftarake dhe të merrte komandën ushtarake në këto rajone. Ai ishte gjithashtu i autorizuar të lëshonte direktiva ligjore, të krijonte gjykata të veçanta dhe të ushtronte kompetencat e tij duke e shtrirë spektrin urdhërues deri në zyrat përkatëse territoriale.

Ashtu siç praktikohesh edhe në vendet e tjera të pushtuara, Wehrmacht-i shoqërohej edhe nga Arma SS dhe policia. Për këtë arsye Himmler, Reichsführer-i i SS-ëve dhe shef i policisë gjermane, emëroi në fund të tetorit 1943 si të dërguarin e tij në Shqipëri Gjeneralmajorin e Armës SS dhe të policisë Fitzthum.

Masat me karakter ushtarak

Gjenerali komandues i pushtimit, Komandanti i Korparmata XXI malore ngriti shtabin e tij në Tiranë. Korparmata XXI malore ishte në varësi të Armatës së 2-të tankiste, e cila varej nga Grupi luftarak i Forcave Tokësore F në Beograd, që komandohej nga Gjeneralfeldmarshalli Maximilian von Weichs, i cili ishte njëkohësisht edhe Komandanti i Përgjithshëm i Juglindjes. Korça dhe Gjirokastra ishin në varësi operative të Korpusit XXII malor, që ishte stacionuar në Greqinë e Veriut dhe ishte në varësi të Grupi luftarak E të Forcave Tokësore. Sipas ditarit luftarak të Komandës së Lartë të Wehrmacht-it Korparmata XXI malore përbëhej

nga: Divizioni 118 i këmbësoresë së lehtë, Divizioni 297 i këmbësoresë (në formatim), Divizioni 100 i këmbësoresë së lehtë, Divizioni 181 i këmbësoresë së lehtë (duke u transportuar). Prej mesit të tetorit 1943 Divizioni 118 i këmbësoresë së lehtë u zëvendësua me Divizionin 181 të këmbësoresë. Edhe ky Divizion kaloi më vonë, si pasojë e riformatimeve të forcave gjermane, në Mal të Zi nën komandën e Korparmatës së 5-të malore. Kësisoj që, në territorin shqiptar ishin vetëm dy Divizione të stacionuara, përkatësisht Divizioni 297 i këmbësoresë në Veri dhe Shqipërinë e Mesme, si dhe Divizioni 100 i këmbësoresë së lehtë në jug të Shqipërisë. Më 22 shkurt 1944, Divizioni 100 i këmbësoresë u zëvendësua nga Divizioni 181 i këmbësoresë. Përkrah këtyre Divizioneve, në Shqipëri operonin, prej 1 shkurtit 1944, edhe Regjimenti 1 "Brandenburg", dy batalione turkmenësh dhe një repart artilerie.

Në rast se do të llogaritet edhe Divizioni I Malor, që operonte në rajonin Janinë-Tepelenë dhe që përbënte njëkohësisht edhe forcat rezervë sulmuese të Grupi Luftarak, formohej një numër prej afërsisht pesë Divizionesh, të cilët duhej të mbanin regjimin e pushtimit në Shqipëri dhe në Malin e Zi. E njëjta hapësirë ishte mbajtur më parë nën kontroll, me shumë sforcim, nga tetë Divizione italiane!

Detyra kryesore e këtyre Divizioneve ishte padyshim organizimi i mbrojtjes së vijës bregdetare nga ndonjë zbarkim i mundshëm i forcave aleate. Kjo detyrë nënkuptonte pushtimin e territoreve të rëndësishëm bregdetarë, ndërtimin dhe zgjerimin e pozicioneve të artilerisë bregdetare dhe rikthimi në gjendje luftarake i baterive të artilerisë bregdetare, që u ishin kapur forcave italiane.

Tentativat e konsolidimit të pushtimit

Në rast se do të vlerësojmë situatën e asaj kohe sipas kriterëve të së drejtës ndërkombëtare, është e pamundur që të flitet për një pavarësi të vërtetë dhe një ringritje të pavarur të shtetit shqiptar.

Me formimin e qeverisë Mitrovica mbaroi edhe faza e formësimit të pushtimit gjerman në Shqipëri. Antagonizmi në rritje ndërmjet Ballit Kombëtar dhe Frontit Nacionalçlirimtar u bë një nga faktorët kyç për politikën e jashtme gjermane në Shqipëri. Premtimet e tyre, që pushtimi ishte një pasojë e pastër e nevojave ushtarake, lidhur me garancinë e një Shqipërie të pavarur, zgjonte te nacionalistët

shqiptarë shpresën për realizimin e një politike të brendshme dhe të jashtme relativisht të pavarur.

Mesa duket edhe për ballistët pavarësia e pretenduar mjaftoi për të shmangur konfrontimin me trupat gjermane dhe si fillim të pranonin realitetin e vendit të pushtuar. Argumenti i gjermanëve, që në vend duhej të mbizotëronte rendi dhe qetësia u pranua nga gjithë forcat nacionaliste me përjashtim të Lëvizjes Nacionalçlirimtare partizane.

Hyrja e shpejtë e trupave gjermane në Shqipëri si edhe strategjia e tyre pushtuese kërkonin një orientim të ri politik dhe strategjik të Ballit Kombëtar. Pa marrë parasysh se cila palë ishte përgjegjëse për dështimin e Marrëveshjes së Mukjes, për Ballin Kombëtar opsioni i luftës kundër pushtuesve gjermanë, pa bashkëpunuar me LNÇ, por me grupimet e tjera jo komuniste dhe me mbështetjen e anglezëve mbeti i hapur. Ndërkohë një opsion tjetër ishte edhe ai që të qëndronte neutral dhe të priste ndonjë zbarkim të aleatëve ose të bashkohej me pushtuesit gjermanë dhe, së bashku, të luftonin kundër partizanëve.

Supozimi që Balli Kombëtar ishte i detyruar të bashkëpunonte me gjermanët si pasojë e fillimit të luftës civile është tepër i dyshimtë dhe i diskutueshëm sepse, ndërmjet partizanëve dhe ballistëve kishin ndodhur deri në fund të tetorit 1943 vetëm përplasje ushtarake sporadike dhe nuk ekzistonte akoma asnjë direktivë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare për të luftuar kundër Ballit Kombëtar apo grupimeve të tjera jo komuniste. Siç vërehet, si Balli Kombëtar ashtu edhe Partia Komuniste kishin të njëjtin shqetësim, sigurimin e drejtimit të vendit pas largimit, tashmë të parashikueshëm, të gjermanëve nga Shqipëria.

Bashkëpunimi i Ballit Kombëtar me gjermanët i shërbeu Partisë Komuniste që si fillim, ta demaskonte atë në popull dhe më vonë ta godiste përfundimisht. Nga ana tjetër, Balli Kombëtar ndiqte po të njëjtën strategji, pra likuidimin me çdo kusht të lëvizjes komuniste, strategji kjo që nuk e pengonte atë të bashkëpunonte ndërkohë edhe me gjermanët.

Formimi i lëvizjes së Legalitetit mund të shihet si një rrjedhim i këtyre zhvillimeve politike në vend. Në thelbin e saj, ideologjia e programit zogist ishte antifashiste dhe bazohej mbi elementë të matriksit kombëtar si kufijtë etnikë, rritja e standardit të jetesës për popullsinë dhe një reformë agrare. Ky program kishte të njëjtin ngjyrim si ai i Ballit Kombëtar, por ndryshonin nga njëri-tjetri në një pikë, ku zogistët kërkonin rikthimin e Legalitetit, pra rikthimin e monarkisë. Acarimi i situatës së brendshme, që

u kurorëzua me luftën e hapur të partizanëve të UNÇ-së kundër ballistëve, i la Kupit të kuptonte, që edhe atë dhe organizatën e tij e priste i njëjti fat. Kështu që ai nxitoi të deklaronte se ai nuk do të sulmonte komunistët nëse edhe ata nuk do ta sulmonin atë.

Kërkesat e oficerëve ndërlidhës britanikë që ndodheshin të atashuar pranë Abaz Kupit, për të ndërmarrë sulme luftarake ndaj Wehrmacht-it gjerman, nuk u morën në konsideratë prej zogistëve. Madje, pavarësisht nga qëndrimi antifashist i shpallur në program, zogistët nuk ngurruan që, në heshtje të bënin marrëveshje me gjermanët, të ruanin kontaktet me politikanët kolaboracionistë dhe të përpiqeshin të vendosnin nëpunës dhe oficerë të orientuar drejt monarkisë në poste të rëndësishme të administratës apo në ushtri.

Dështimi i pushtimit gjerman

Zhvillimet e situatës politike dhe asaj ushtarake në gjithë rajonin e Ballkanit, ashtu si edhe në Shqipëri, ku forcat komuniste po fitonin ndjeshëm terren, kërkonte si nga forcat kombëtare ashtu dhe nga gjermanët një rishikim të politikës së ndjekur prej tyre. Abaz Kupi, qëndrimi i të cilit e kthente atë *de facto* në bashkëpunëtor të gjermanëve, filloi në gjysmën e dytë të gushtit 1944 të orientohet fuqishëm drejt aleatëve. Pak kohë pas dorëheqjes së qeverisë Dine, kuislingët e Ballit Kombëtar dhe Legalitetit u larguan nga Tirana. Largimi i tyre nuk përbënte ndonjë rrezik akut për gjermanët sepse rëndësia e tyre politike dhe ushtarake tashmë kishte humbur peshë. Sulmet e pakoordinuara, dhe si pasojë të parëndësishme, të zogistëve të ndihmuar nga oficerët britanikë kundër gjermanëve, patën një rëndësi periferike dhe shpesh u klasifikuan nga gjermanët si sulme të UNÇ!

Zonat që ishin direkt ose indirekt nën ndikimin gjerman filluan në gjysmën e parë të shtatorit 1944 të merrnin pamjen e ishujve. Me gjithë këto zhvillime gjermanët mundoheshin të mbanin në vend akoma gjallë imazhin e normalitetit. Sigurisht që, atyre nuk u bëhej vonë për konfliktet e stabilitetit të brendshëm të vendit, por shpresonin të ngadalësonin degjenerimin e brendshëm të sistemit pushtues.

Urdhri për tërheqjen e Wehrmacht-it nga Shqipëria u lëshua më 3 tetor 1944, në të njëjtën kohë me tërheqjen e trupave gjermane nga Greqia dhe Maqedonia. Grupi luftarak E i Forcave Tokësore kishte në Greqi rreth 280.000 forca, të cilat kaluan në ditët e para të nëntorit 1944 kufirin e Greqisë në drejtim të Jugosllavisë, ndërsa një forcë prej 5000 ushtarësh, nën drejtimin e Komandantit të Grupit të Artilerisë, Koloneli Steyrer [*Shtajrer*] morën detyrë që të marshonin në drejtimin Ohër-Elbasan-Tiranë. Ky grupim u urdhërua të ndihmonte tërheqjen e forcave gjermane që ndodheshin në Tiranë.

Tërheqja nga Shqipëria ishte e lidhur ngushtë me tërheqjen e trupave gjermane nga Greqia. Për këtë arsye, tërheqja e Korparmatës Malore XXI mori një rëndësi të veçantë. Kjo Korparmatë nuk mund të kryente një tërheqje të menjëhershme sepse ekzistonte rreziku i një zbarkimi eventual të trupave aleate në bregdetin shqiptar dhe ajo duhej të siguronte rrugëkalimin e tërheqjes nga Greqia dhe Maqedonia për trupat gjermane që ishin të stacionuara në këto vende.

Tërheqja e Wehrmacht-it nga Shqipëria, konkretisht e Divizionit 297 të Këmbësorisë, filloi nga Vlora, në fund të tetorit 1944, e koordinuar me lëshimin e ishullit të Korfuzit dhe qytetit të Sarandës.

Tërheqja duhej të realizohej në drejtim të Veriut të Shqipërisë duke pasur si orientim të përgjithshëm të saj luginat e lumenjve që shtriheshin nga lindja në drejtim të perëndimit të Shqipërisë. Ky plan eci fillimisht mirë. Në Shkumbin tërheqja gjermane ra nën një presion të madh të forcave partizane. Meqenëse Grupi luftarak Steyrer, i cili vinte nga Struga, u vonua, duhej që të mbaheshin këto pozicione disa ditë më shumë sesa ishte planëzuar.

Pas tërheqjes së gjermanëve më 17 nëntor 1944 nga Tirana, më 22 nëntor, trupat e mbetura të Korparmatës XXI arritën në qytetin e Shkodrës. Meqenëse tërheqja nëpër Nikshiq në drejtim të Trebinjës e Mostarit nuk ishte e mundur, si pasojë e presionit luftarak që ushtronin forcat partizane. Komandanti i Përgjithshëm gjerman i Juglindjes fluturoi personalisht, më 22 Nëntor 1944 në drejtim të Shqipërisë, për të marrë një vendim për drejtimin e ri për tërheqjen e Korpusit. U vendos, që trupat të ktheheshin në Podgoricë në drejtimin Ura e Bioçes – Vjetarnik - Kolashin - Prijepolje (Serbi), këto forca do të bashkoheshin me trupat e tjera gjermane që tërhiqeshin nga Maqedonia. Kjo rrugë tërheqje ishte tepër e vështirë për t'u ndjekur, sepse në të

kishte shumë ura dhe po ashtu rruga ishte shumë e ngushtë. Më 22.11.1944, pararoja e Grupimit të Forcave Tokësore E, që tërhoqej nga Greqia arriti në Sarajevë, duke krijuar një pikëmbështetje për tërheqjen e trupave gjermane nga Shqipëria.

Fati i tërheqjes dhe shpëtimi i trupave të Korparmatës XXI përcaktohej nga ura e Bioçes, pranë Podgoricës, e cila u kap prej trupave gjermane, ndonëse në gjendje të shkatërruar, më datën 28 nëntor 1944.

Kjo urë e ndërtuar mbi lumin Moraça, disa kilometra në jug të Manastirit të Moraçës, me një lartësi prej 50 metrash ishte hedhur në erë, duke u bërë e papërdorshme.

Situata e trupave gjermane të “ngecura” në Shkodër si pasojë e bllokimit të rrugës së tërheqjes, raportohet edhe në Ditarin Luftarak të Ëehrmacht-it për datën 27 nëntor 1944: *“Fronti i Adriatikut: Korparmata Malore XXI: presion i vazhdueshëm i bandave (partizanëve - M.K) në pozicionin pengues në jug të Shkodrës. Në jugperëndim të Podgoricës rritje e intensitetit luftarak. Zgjerim i pozicioneve tona në kryeurën Bioce.”*

Një ditë më pas, më datën 28 nëntor po në këtë ditar raportohet: *“Fronti i Adriatikut: Presion i vazhdueshëm i bandave ndaj pozicioneve penguese në jug të Shkodrës. Një regjiment i Korparmatës XXI, filloi nga Bioçe më datën 28.11 herët, lëvizjen për të hapur rrugën deri në Matesevo.”*

Në këto kushte, situata ishte përmirësuar disi për gjermanët, sepse rajoni në të cilin ndodhej ura strategjike ishte marrë dhe lëvizja e trupave të bllokuara në Shkodër, ndërkohë që rruga po çahet me luftim edhe nga drejtimi tjetër, ishte siguruar. Si rrjedhojë, në mbrëmjen e datës 28 nëntor u lëshuan pozicionet penguese në jug të Shkodrës. Në Ditarin Luftarak të Ëehrmacht-it lidhur me ngjarjet e datës 29.11.44 është shënuar: *„ Fronti i Adriatikut: Pozicioni pengues Shkodra është lëshuar nën presionin e bandave në mbrëmjen e datës 28.11. një kompani turkmene dezertoi dhe kaloi te armiku. Sulmet e bandave ndaj kryeurës Bioçe janë sprapsur. Hapja e rrugës së tërheqjes është kryer deri në rajonin e Klopotit.“*

Më 29 Nëntor 1944, trupat gjermane e kishin lëshuar qytetin e fundit më të madh verior të Shqipërisë, Shkodrën. Në raportimin sekret të Komandantit të Përgjithshëm të Juglindjes të datës 30.11.1944 në Komandën e Lartë të Ëehrmacht-it, lidhur me këtë ngjarje shkruhet: *“[...] b) Fronti i Adriatikut: Korparmata XXI Malore: Shkodra u lëshua, praparoja e div. 297 arriti në Koplík (15 km në veri - veriperëndim të Shkodrës) [...]”*

Me këtë veprim kishte përfunduar praktikisht pushtimi gjerman i Shqipërisë dhe trupat gjermane vazhdonin tërheqjen e tyre në drejtim të Gjermanisë.

Nëse u referohemi burimeve gjermane, gjatë periudhës 14-mujore të pushtimit gjerman në Shqipëri ranë rreth 2400 ushtarë gjermanë. Emrat e 1800 prej tyre janë të identifikuar.

Arrestimet dhe deportimet në Mauthausen

Disa nga format e ushtrimit të terrorit dhe dhunës naziste mbi popullsinë civile ishin pushkatimi i i civilëve për çdo ushtar gjerman të vrarë, arrestimet, dëbimet dhe internimet në kampet e përqendrimit si puna e detyruar larg vendit të origjinës. Më 22 tetor 1941 një gazetë franceze La Fur botoi shënimin e mëposhtëm: *“Kriminelë burracakë në shërbim të Anglisë dhe të Moskës më 20 tetor në mëngjes vranë feldkomandantin e Nantës. Vrasësit ende nuk janë arrestuar. Për shlyerjen e krimit kam dhënë urdhër të pushkatohen 50 pengje si fillim 50 pengje të tjerë do të pushkatohen po qe se fajtorët nuk do të jenë arrestuar deri në mesnatën e 23 tetorit”*. Në Francë në Belgjikë në Holandë në Norvegji në Poloni e në Rusi ky lloj njoftimi u bë i zakonshëm në faqet e gazetave, apo në afishet e kuqe me kornizë të zezë. Përpjesëtimi i shpallur publikisht nga gjermanët nuk ndryshonte kurrë: 1 – 100 pengje të pushkatuar për çdo gjerman të vrarë.²

Ende pa e pushtuar administrativisht Shqipërinë, trupat naziste kryen masakrën e Borovës, më 6 korrik 1943. Trupat naziste që herën e parë që shkelën në territorin shqiptar, ndonëse në kalim e sipër nëpër territor shqiptar, përhapën panik duke pushkatuar njerëz të pafajshëm në fshatrat Borovë e Barmash të rrethit të Korçës. Forcat territoriale dhe batalioni antifashist “Tomori” kishin ditë që prisnin për të goditur forcat italiane që do shkonin në Përmet, pasi garnizoni italian ishte rrethuar nga forca të tjera të rezistencës. Në grykat e Barmashit ku kishin bërë pritë partizanët kaloi autokolona me një përbërje prej 300 kamionësh dhe autobлиндash, me ushtarë gjermanë, që bënë pjesë në Divizionin e I Malor. Sulmi i partizanëve shkatërroi 1 motoçikletë dhe u prishën disa makina, ku ngelën edhe disa ushtarë gjermanë të vrarë. Lidhur me këtë ngjarje, komanda e xhandarmërisë njoftonte Ministrinë e Brendshme se *“forcat gjermane tue ardhun nga Follorina, për kalim tranzit në Janinë, kur arritën midis katundeve Borovë-Barmash, u goditën nga çetat nacionalçlirimtare, të komanduara nga Riza Kodheli”*. Në këtë përpjekje, që vazhdoi për shtatë orë rresht, nga ushtria gjermane thuhet se mbetën të vrarë 4 ushtarë dhe të plagosur 12. Nga kjo goditje e papritur trupat gjermane ushtruan terror të pashembullt mbi popullsinë e pafajshme dhe të pambrojtur të katundeve Borovë e

² Shiko Dr. Dorian Koçi: “Historia e të arrestuarve dhe të mbijetuarve shqiptarë në kampin famëkeq të Mauthausen-it në Austri”. (CD bashkëngjitur).

Barmash, duke vrarë në Borovë 107 veta e plagosur 8 dhe po 8 veta në Barmash. Shumica e të masakruarve ishin gra me fëmijë të vegjël, vajza të pamartuara, por edhe fëmijë të vegjël. Masakra e Borovës është masakra e parë dhe më e madhe që nazistët gjermanë kryen ndaj popullsisë civile në Shqipëri në vitet e Luftës së Dytë Botërore. Borova u bë simbol i sakrificës së popullit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Arrestimet dhe deportimet e njerëzve aktivë të rezistencës por edhe të civilëve të thjeshtë në kampet e përqendrimit në Gjermani dhe Austri ishin mjeti tjetër i pushtetit administrativ ushtarak nazist në Shqipëri për të ushtruar terror. Në vjeshtën e vitit 1943, kryesisht në tetor dhe nëntor 1943 trupat gjermane në bashkëpunim me forcat kolaboracioniste realizuan dy operacione të ashtuquajtura spastrimi ndaj vatrave të rezistencës në Vlorë dhe Durrës. Aksionet e ndërmarra në formën e shpejtë të mënyrës naziste synonin sa të shuanin vatrën e rezistencës po aq dhe të siguronin bregdetin shqiptar nga çdo zbarkim i mundshëm i trupave aleate që ndesheshin në Itali.

Arrestimet në Vlorë

Më datën 10 tetor 1943 në orën 4:30 të mëngjesit forcat gjermane të qytetit të Vlorës ndërmorën operacionin ku u arrestuan shumë qytetarë vlonjatë. Ata nuk do të ndaleshin vetëm në datën 10 tetor. Më 25 tetor ndërmorën një operacion tjetër ndëshkues i cili do të vazhdonte deri në datën 6 nëntor. Të arrestuarit i hipën në kamionë dhe i nisën drejt Kampeve të Përqendrimit. Dokumentet në Arkivin e Shtetit dëshmojnë mbi operacionin gjerman si dhe arsyet përse u ndërmor pikërisht në Vlorë. Mes tyre shquan raportimi që ka bërë komandanti lokal gjerman për Vlorën Jäger [Jeger], komandant i batalionit të I të regjimentit 54 të gjuajtësve alpinë, për eprorët e tij. Dokumenti ka titullin *“Organizimi dhe zbatimi i operacionit të spastrimit kundër bandave komuniste në qytetin e Vlorës.”*

“Prej datës 13 shtator deri më 11 tetor 1943, isha komandant lokal i qytetit të Vlorës. Nga autoritetet lokale mora vesh se Partia Komuniste përfshinte rreth 60-70% të krejt popullsisë së këtij qyteti. Partia Komuniste, me anë të shpërndarjes gjerësisht të trakteve dhe ngjitjes së afisheve nëpër mure, u bëri thirrje tregtarëve për bojkotim etj, duke ndezur kështu një luftë të brendshme në këtë qytet, e cila do të kurorëzohej me një kryengritje kundër gjermanëve nga mesi i tetorit. Plaçkitjet dhe vjedhjet në depot e armëve, të municionit dhe veshmbathjes së ushtrisë italiane dhe në stacionet e

spitaleve ushtarake kryheshin në mënyrë të planifikuar dhe në shkallë të gjerë. Duke ditur se çdo ditë po tërhiqeshin trupa gjermane nga kjo zonë, mendonin se deri nga mesi i tetorit do të arrihej një dobësim i trupave gjermane në Vlorë dhe rreth saj. Sjellja korrekte e gjermanëve në Vlorë u muar si dobësi.

Mbasi raportova përpara divizionit 100 të gjuajtësve alpinë, gjeneralit Utz, u ngarkova me zbatimin e një aksioni spastrimi në Vlorë, për të arrestuar udhëheqësit e Partisë Komuniste dhe për t'i dalë përpara sulmit të planifikuar kundër Vermahtit gjerman.

Organizimi dhe zbatimi i bastisjeve:

a) Një kompani e gjuajtësve alpinë u caktua për bllokimin e krejt qytetit në të gjithë rrugët, udhët dhe grykat që dalin nga Vlora.

b) Një togë me çiklistë të regjimentit dhe 4 tanke u caktuan për shërbimin e patrullimit gjatë aksionit në gjithë qytetin, për të penguar dalien e civilëve në rrugë.

c) Për bastisjen e mirëfilltë u caktuan grupe (nga një grup për çdo lagje).

Përbërja e gupeve: Nga 20-25 ushtarë. 1 anëtar i feldxhandarmërisë, 1 xhandar civil, 1 kujdestar civil nga çdo lagje.

Armatimi dhe pajisja e grupeve: Revolver, automatik, 1 mitraloz dhe bomba dore, si dhe revolver për raketë ndriçuese, llampa dore dhe shufra. Çdo grup kishte mundësi lëvizjeje, që garantohej nga dy kamiona për secilin grup. Udhëheqësi i grupit, me veturë. Për qëllime lajmërimi ishin caktuar motoçikleta dhe biçikleta. Ndarja e kohës:

Tetë nëpunës të xhandarmërisë shqiptare u dërguan në selinë e komandaturës, nën pretekstin e një patrullimi të përbashkët gjatë natës. Detyra e këtyre anëtarëve xhandarmërisë shqiptare ishte t'i tregonin grupit gjerman shtëpinë e të ashtuquajturit kryeplak (kujdestarit të lagjes). Në ditën e operacionit të bastisjes, qyteti ishte bllokuar nga brenda dhe jashtë, duke filluar nga ora 4 e mëngjezit. Në orën 4 u zhvillua bisedimi i fundit në komandaturën lokale. Çdo grup kishte një listë të udhëheqësve të Partisë Komuniste, që duheshin arrestuar. Në orën 4.30, grupet gjermane u nisën menjëherë në të njëjtën kohë në lagjet e veçanta të caktuara dhe filluan me arrestimet e udhëheqësve komunistë sipas listës. Pjesa më e madhe e tyre u nxuar nga krevatet.

Një pjesë e komunistëve që u arrestuan, të cilët ishin futur në krevat me revolver të ngarkuar, me pushkë të ngarkuar dhe me bomba dore, bëri rezistencë, por kjo rezistencë e tyre u thye me shpejtësi dhe në mënyrë energjike. Shtëpitë e personave që do të arrestoheshin, në mënyrë të planifikuar u rrethuan, kështu që ishte e

pamundur të iknin. Udhëheqësit e grupeve hynë në shtëpitë bashkë me 3-4 ushtarë nga më të fortit, arrestuan komunistin dhe bënë një kontroll të hollësishëm të shtëpisë nga bodrumi deri në çati, për të kërkuar municion, armë dhe plaçkë tjetër të zënë italianëve. Në këtë mënyrë u zu një depo e madhe armësh dhe municioni me armë dore të rënda e të lehta, rreth 3 tonë municion dhe sasi të mëdha veshmbathje dhe pajisesh italiane si dhe materiale mjekësore. Aksioni përfundoi rreth orës 8.00. U arrestuan gjithsej 393 vetë. Mbas një kontrolli të hollësishëm të gjithë të arrestuarve me ndihmën e përkthyesve, në bazë të të dhënave të autoriteteve u mbajtën 160 komunistë, tek të cilët u gjendën armë dhe municion. Komunistët që u mbajtën, u futën në burgun civil të qytetit dhe të nesërmen u dërguan në Semlin, afër Beogradit. Duket se shefi komunist i zonës Rrahman Dibra, e ka lënë qytetin. Gjatë një kontrolli të të sëmurëve në spitalin civil u zbuluan 6 partizanë të plagosur. Në zyrën e spitalit civil të fshehura mbrapa akteve, u gjendën revolverë, municion gjerman dhe italian si dhe bomba dore .Me këtë ndërhyrje të befasishme u arrit në fakt, që të zbulohen dhe arrestohen të gjithë udhëheqësit kryesorë të pranishëm në qytet. Në këtë mënyrë u krye plotësisht detyra dhe u ndalua kryengritja e planifikuar e Partisë Komuniste. Në një letër të Partisë Komuniste dërguar një njeriu të besueshëm, Partia Komuniste pranonte vetë se gjatë kësaj bastisjeje kishte humbur shumë nga udhëheqësit e partisë, të cilët tani ishin në burg dhe duheshin liruar me doemos”.

Nga të 393 të arrestuarit vetëm 160 u mbajtën dhe u dërguan në Kampin e Përqendrimit Semlin afër Beogradit. Më andej një pjesë e tyre u dërguan në Kampin e Mauthausen-it në Austri.

Arrestimet në Durrës

Një operacion tjetër ndëshkimor u zhvillua dhe në qytetin e Durrësit ku sërish u arrestuan anëtarë të rezistencës antifashiste dhe qytetarë durrsakë. Nga dokumenti datë 17.11.1943 informohemi për nisjen e repartit tankist-gjuajtës dhe të batalionit të 3-të 522 drejt Durrësit, Shijakut dhe Kavajës, në datat 19 dhe 20 nëntor. Me këtë rast njoftohet se që nga data 17.11 e gjer më 21.11.1943 *"Tirana do të mbetet përkohësisht pa trupa, pasi ata do të sigurojnë rrugën Tiranë-Durrës në pjesën veriore të saj". Këtu bëhet fjalë për bastisjet masive që do të bënin gjermanët nën emrin konvencional "Hafenfahrt" (Shëtitje në port). Regjimenti "Grenadier-522" mbylli dhe bllokoi nga brenda e nga jashtë gjithë rrugët e Durrësit e të Shijakut. Në një*

dokument tjetër të armikut thuhet: *"U kapën hëpërhë të gjithë burrat që u gjendën, dhe të tjerë, të cilët u futën brenda nga jashtë, me automjete, nga të dy krahët, nga Tirana dhe Rrogozhina..."* Nga dokumenti i datës 21.11.1943, domethënë, katër ditë më vonë, mësohet se: *"... Gjatë bastisjeve në Durrës, Shijak e Kavajë më 20 dhe 21 nëntor, u kontrolluan gjithsej 6700 burra, nga të cilët u arrestuan 812 komunistë të Shqipërisë..."* Një dëshmitar i mbijetuar i këtyre arrestimeve dhe depërtimeve drejt Kampit të Mauthausen-it, Abdulla Krutani rrëfen se *"Unë jam internuar në vitin 1943 dhe deri nga fundi i nëntorit kam qenë në burgun e Tiranës, me shokët Kozma Nushi, Talat Noka. Më pas na çuan në tokat e Jugosllavisë, në kampin e Zemunit, pastaj në Beograd ku kemi ndenjur nga 5 muaj në secilin vend. Pastaj na çuan në perëndim. Kur më kapën, isha partizan, në Pezë. Aty na kapën mua dhe shumë shokë të tjerë. Udhëtimi ka qenë me autokolonë deri në Beograd, pastaj me tren drejt perëndimit. Rruga deri në kamp ka qenë një sfidë më vete, ku gjermanët nga frika e ndonjë revolte për arratisje i linin të burgosurit të thaheshin për ujë. Nuk na jepnin ujë fare. Mbaj mend që binte shi dhe qitnim duart jashtë për të njomur pak buzët. Na kishin rrethuar me tela që mos të kishim mundësi të arratiseshim. Aty na vdiq një shok, gjatë udhëtimit. Pandi Dhimo, korçar, alamet djali. Vdiq për një pikë ujë",* më thotë me zërin e qartë. Prej andej në shtator të vitit 1944 të arrestuarit shqiptarë u dërguan në Kampin e Mauthausen-it.

Një dëshmitar tjetër Enver Plepi kujton momentin e arrestimit në Durrës. "Hafenfahrt", (shëtitje në port) e quajtën gjermanët operacionin në të cilin u mobilizuan afër 4 mijë ushtarë. *"Unë po kthehesha nga Kavaja, ku kisha shkuar te njerëzit e mi, kur hasa në një postbllok, nuk mendova se do të kishin ndonjë gjë me mua dhe kështu qëndrova. Më vunë në radhë me shumë të tjerë. Ende nuk e dija se çfarë fati po më përgatitej".* Kishte nisur kalvari i gjatë i qindra njerëzve. Shumë nuk u kthyen më kurrë. *"Na grumbulluan te një shesh i madh atje, ku më pas u ndërtua Uzina e Plastikës. Pas nja dy orësh na nisën për Tiranë me disa kamionë të mëdhenj ushtarakë. Duhej të kemi qenë aty rreth 600 vetë nga Durrësi. Shumica ishin në moshë, vetëm unë e nja tre katër të tjerë ishim të rinj. Në Tiranë na kanë strehuar në Burgun e Ri, atje ku është sot Reparti 313. Për afër dy ditë ka vazhduar seleksionimi. Mbaj mend një shqiptar që ndihmonte gjermanët në këtë punë. Mbante një pardesy dhe një borsalinë të madhe, quhej Osman Velja. Ai i njihte vetë personalisht shumicën prej nesh. Atëherë kam dëgjuar për herë të parë në jetën time komandat: Rechts, links (majtas, djathtas). Nga seleksionimi i parë mbetëm 200 vetë*

dhe më pas kemi qenë aty afër 100 që mbetëm në fund. Na patën thënë se gjatë këtyre ditëve shumë njerëz ishin mbledhur para dyerve të burgut në pritje të fatit tonë. Madje, andej nga paraditja e 28 nëntorit, Ditës së Pavarësisë, ky grumbullim ishte shndërruar në një demonstratë të heshtur. Që atëherë, në ndonjë rast që më bie të kaloj andej nga burgu, i hedh sytë asaj dritares me hekura të burgut. Më duket sikur e përjetoj edhe një herë po aq fort, frikën dhe ndjenjën e pasigurisë që na kishte kapur në atë kohë. Pastaj na hipën në kamionë. Me këtë rast mësova edhe një fjalë tjetër gjermanisht: Komm (eja). Me dy ushtarë gjermanë para dhe katër mbrapa, kamionët morë rrugën e Elbasanit. Kemi ndenjtur një ditë në burgun e këtij qyteti për të mbërritur më pas në Strugë. Mbaj mend se na kishin mbetur ende disa para nëpër xhepa dhe na dhanë leje të blejmë ca petulla, të cilat i përpimë brenda pak minutash. Në Strugë jam njohur edhe më mirë me Kozma Nushin, Telat Nogën, Enver Veljen, Vasil Misjen, Leonidha Hebën dhe të tjerë. Në darkë kemi mbërritur në Manastir, ku na kanë mbajtur afër një muaj. Na kanë marrë gjatë në pyetje dhe më në fund na lajmëruan se destinacioni ynë i fundit ishte internimi. Se ku do të na çonin, as që e shkonim atëherë ndërmend." Deri në atë kohë kishim dëgjuar për egërsinë e trajtimit në burgjet naziste, por të dëgjosh është tjetër gjë dhe ta provosh e ta shohësh vetë me sy është tjetër gjë - vazhdon Enveri rrëfimin tashmë krejt i përfshirë nga kujtimet e asaj kohe - në korrik të 1944 na kanë sjellë me tren në Zemun, një kamp i madh përqendrimi në Serbi. Atje kishte afër 5 mijë të internuar nga i gjithë Ballkani, që më pas i nisnin për në kampe të tjera. Mijëra vetë flinin në një ndërtesë trekatëshe të ngjitur me njëri-tjetrin. Këtu nisëm të nuhasim për herë të parë erën e vdekjes. Ishte shumë keq për ushqim dhe ujë. Nuk vonoi shumë dhe ra një epidemi e rëndë tifoje. Qindra të burgosur vdiqën. Këtu humbëm të parët shokë nga Durrësi. 18 durrsakë nuk e përballuan dot sëmundjen. Në Zemun më kanë bërë përshtypje dy njerëz, që nuk do t'i harroj sa të jetë jeta. Njëri prej tyre ishte Mihal Konomi, nga Vlora. Ai ishte mjek dhe gjermanët i propozuan kushte më të mira nëse pranonte të ishte mjeku zyrtar i kampit. Vasili nuk pranoi, qëndroi pranë nesh duke na ndihmuar sa kishte mundësi, por nuk u nda nga shokët. Një tjetër emër më ka mbetur në mendje: Mihal Marko. Ky më dha një batanije. Tani mund të duket një gjë e vogël, porse në atë kohë ishte gati si të të shpëtonte jetën. Për fat, të dy i mbijetuan kampeve dhe u kthyen pranë familjeve. Nuk kaloi shumë kohë dhe na bënë sërish gati për nisje me trena. Këtë herë destinacioni ishte Banica, një rrethinë e Beogradit. Këtu, një godinë katërkatëshe e gjimnazit ishte shndërruar në burg

politik. Ne, shqiptarëve, na strehuan në disa baraka të lehta në oborrin e burgut. E kuptuam se këtu nuk do të rrinim shumë. Tortura më e madhe në Banac ishte uria. Ishte një vuajtje e pashoqe që ia paska kaluar çdo lloj torture, porse pas disa ditësh u gjet një zgjidhje. Me anë të alfabetit me gishta, si ai që përdorin shurdh-memecët, arritëm të lidheshim me të burgosurit që ndodheshin në qelitë përballë nesh. Ata ishin diçka më mirë se ne, sepse një herë në javë u vinte ushqim nga familja. Ata nisën të vinin ushqime në parvazin e dritareve të tyre. Mirëpo që të shkoje deri te dritaret e tyre me hekura ishte fort me rrezik, sepse rojet qëllonin pa paralajmërimin çdo njeri që kapërcente oborrin e barakave. Mbjaj mend që këtë punë e kemi bërë unë, Mustafa Elezi, nga Kavaja, dhe ndonjë shok tjetër. Më andej Enver Plepi dëshmon për dërgimin e tij dhe të shqiptarëve të tjerë drejt Kampit të Mauthausen-it. "Ishte 15 shtatori i 1944. Na hipën nëpër disa vagonë mallrash të gjithë ngjitur njëri me tjetrin. Pa bukë, pa ujë dhe pa dalë. Merrnim ajër vetëm nga disa dritare të vogla lart. Prej tyre mësonim nëse ishte natë a nëse ishte ditë. Udhëtimi ka zgjatur pesë ditë. As që e kishim idenë se ku po shkonim e çfarë vendesh po kalonim. Hera e parë që zbritëm në tokë në mes të udhëtimit ishte kur dha shpirt Vasil Gjata, ish-polic i Bashkisë së Durrësit. E vendosëm trupin e tij në anë të hekurudhës dhe nuk morëm vesh më tej se ç'u bë me të. Në një farë kuptimi, Vasili i shkretë u bë viktima e parë e Mauthausen-it të mallkuar. Në 20 shtator 1944 e dëgjova për herë të parë emrin e tij: Mauthausen - vazhdon dëshminë e tij Enveri - ishim në Austri, në afërsi të Linz-it. Na rreshtuan para portës së tij të madhe dhe pashë pas saj me mijëra figura njerëzore që lëviznin si pa kuptim. Mijëra vetë të veshur me rrobe me vija vërtiteshin në një peizazh krejt të zhveshur. Ndërsa po prisnim, m'u afrua si me ndrojtje një figurë e mjerë. M'u drejtua në italisht. I thashë se vijmë nga "Durazzo". Tundi kokën me trishtim dhe bëri me gisht nga porta e kampit: E sheh atë portë, ajo është porta e hyrjes. Deri tani nuk ka pasur portë daljeje. Por ti je i ri, do Zoti dhe mbijeton. Kurrë nuk do të më hiqet nga mendja portreti i atij njeriu. Më pas na zhveshën lakuriq dhe na i morën të gjitha rrobat. Para se të vishnim uniformat bardhë e blu, na çuan në dushe. Vonë, shumë më vonë, e kemi marrë vesh se kishte dy lloj dushesh: njëri ishte ky që bëmë ne. Tjetri të çonte direkt drejt vdekjes, ishin dhomat me gaz. Ne shpëtuam, ishim të rinj. Një ditë më pas nisi ferri i vërtetë. Na çuan në punë që në të gdhirë. Që tani e tutje nuk ekzistonin më emra. Ne ishim vetëm numra. Unë e kisha 100266. E gjithë puna ishte që të mbaje një gur afër 20-30 kile në kurriz nga gurorja deri në afërsi të kampit, ditë për ditë, në dimër e në vapë, në të ftohtë a në shi, e

njëta gjë që të çonte drejt vdekjes së sigurt. Të rreshtuar për katër, nën komandën e atyre që i quanin "kapo", që ishin të burgosur të privilegjuar, duhej të kapërcenim me dhjetëra herë në ditë të 183 shkallët e së përpjetës së mallkuar të gurores. Mbaj mend Telat Nogën, që u mundua të ndihmonte një të burgosur që u shemb përdhe. Kapot vrapuan sakaq drejt tij. Ishte e ndaluar të ndihmoje tjetrin. Kush ishte i dobët duhej të vdiste. Ky ishte rregulli. Me të vdekurit nisën të na mësohen sytë. Ata i shihje kudo: në gurore, në rrugët e kampit, në banjo, kudo. Mbaj mend që një mëngjes, kur u zgjova, pashë se shoku im i krevatit kishte dhënë shpirt. Nuk e mësova kurrë se nga ishte. Ishim aq të lodhur e të paushqyer sa që nuk kishim as fuqi për të folur. Kështu vazhdoi jeta jonë, nëse mund të quhet jetë deri në majin e 1945. Nga Shqipëria kishim ardhur mbi 400 vetë, tani kishim mbetur një grusht. Të tjerët, Kozmai, Telati, Enver Velja, e shumë e shumë të tjerë nuk e përballuan dot. Po sikur edhe pak ditë të kishte vazhduar kjo histori, tani nuk do të ishim duke folur këtu bashkë".

GESTAPO [Geheime Staatspolizei – Policia e Fshehtë e Shtetit]

Menjëherë pas ardhjen në pushtet në vitin 1933, Hitler-i urdhëroi një riorganizim të gjithë institucioneve shtetërore. Në këtë kuadër, drejtuesi i forcave SS, ristrukturoi forcat e policisë gjermane që ishin nën komandën e “Drejtuesit të Rajhut SS dhe Shefit të Policisë”, Heinrich Himmler, i cili e kishte zyrën në Berlin dhe përgjigjej para Hitler-it për rendin dhe qetësinë në gjithë Gjermaninë. Për të realizuar këtë detyrë, Himmler-i krijoi dy zyra qendrore, Zyrën Qendrore SS dhe Zyrën Qendrore për Sigurinë.

Zyra Qendrore SS duhej të merrej me riorganizimin e formacioneve të Armës-SS. Gjatë krijimit të formacioneve SS u morën masa që ushtarët që rekrutoheshin të zgjidheshin me kujdes. Kushtet kryesore ishin fanatizmi politik, të kishin një gjatësi trupore prej të paktën 1.80 metër, të ishin me sy bojë qielli dhe flokëverdhe. Sipas botëkuptimit nacionalsocialist, këto trupa duhej të ishin elita e ushtrisë gjermane dhe nëse ishte nevoja, të hapnin zjarr edhe kundër popullit të tyre, nëse do të rrezikohej diktatura naziste që po instalohesh në Gjermani. Në fillim të Luftës së Dytë Botërore trupat e Armës-SS nuk u përdorën për luftime në vijë të parë të frontit, por ato futeshin menjëherë në terrenet e sapo pushtuara, për t'i mbajtur ato nën kontroll. Për herë të parë trupat SS u përdorën për luftime frontale në sulmin ndaj Bashkimit Sovjetik dhe në Ballkan, ku ishin krijuar formacione të fuqishme partizane, të cilat vlerësoheshin si formacione fanatike politike.

Nëse organizimi i Armës-SS u krye në mënyrë zyrtare dhe të hapur, organizimi i Zyrës Qendrore për Sigurinë ishte sekret. Shefi i kësaj zyre ishte nacionalsocialisti i betuar me origjinë austriake, Ernst Kaltenbrunner. Ai ishte edhe shefi i Gestapo-s, organit më të rëndësishëm të diktaturës nacionalsocialiste, që kishte për detyrë të zbulonte dhe asgjësonte çdo qëndresë politike ndaj regjimit dhe të garantonte sigurinë e institucioneve të reja shtetërore. Për këtë qëllim u krijua Zyra e Shërbimit të Brendshëm SD, me seli në Berlin. Prej këtu organizohej kontrolli dhe survejimi i gjithë njerëzve, sidomos i kundërshtarëve politikë, të cilët pakësoheshin dita-ditës dhe ndonëse nuk bënin asnjë shkelje ligjore, dërgoheshin në kampe përqendrimi ose ekzekutoheshin në masë, duke u përdorur të gjitha mënyrat e rafinuara që ofronte asokohe shkenca dhe teknologjia. Për të zbuluar kundërshtarët politikë u krijuan Komandat Vendore SD, të cilat ishin vendosur në çdo qytet të madh dhe

informoheshin nga njerëzit e besuar, pra agjentët, për aktivitetet politike të qytetarëve. Këto organe represive arritën që brenda një kohe të shkurtër të mbillnin psikozën e frikës dhe pasigurisë dhe të thyenin kësisoj qëndresën e brendshme të popullit gjerman.



Kaltenbrunner-i në spitalin e Gjykatës së krimeve të Luftës, Nürenberg.
(Burimi: <https://www.trumanlibrary.gov/photograph-records/72-843>)


Një aspekt tjetër i instalimit të diktaturës hitleriane ishte manipulimi i masave ndërmjet një rrjeti të sofistikuar propagande të udhëhequr nga nazisti i orëve të para Joseph Goebbels [*Jozef Gëbels*]. Në vendet totalitare propaganda dhe terrori paraqet dy anë të së njëjtës monedhe. Kudo që totalitarizmi zotëron kontroll absolut, ai zëvendëson propagandën me indoktrinimin dhe e përdor dhunën jo aq sa për të frikësuar njerëzit, sesa për të realizuar vazhdimisht doktrinën e tij ideologjike dhe gënjeshtret e tij praktike.

Pas asgjësimit të kundërshtarëve politikë dhe propagandës së ndërlikuar, si pasojë e së cilës një pjesë e konsiderueshme e popullit gjerman u kthyen në vegël qorre e Nacionalsocializmit, filluan në fshehtësi përgatitjet për një luftë të re. Për këtë qëllim u krijua Zyra e Shërbimit të Jashtëm SD, e cila kishte për detyrë të shtrinte rrjetin e saj në gjithë vendet e tjera. Punonjësit e kësaj zyre dërgoheshin nëpër botë, të maskuar si anëtarë të trupit diplomatik gjerman në ambasada, konsullata dhe legata ose si përfaqësues të firmave gjermane. Sigurisht që kjo gjë bëhej në mënyrë të

fshehtë dhe asnjë nuk e dinte detyrën e tyre të vërtetë. Ndërkohë që e vërteta ishte tërësisht ndryshe.

Gestapo e filloi aktivitetin e saj në Shqipëri që para pushtimit italian të vendit. Për këtë qëllim, ajo dërgoi disa agjentë të saj në Shqipëri, me detyrë mbledhjen e informacioneve politike. Të gjithë këta agjentë ishin në bashkëpunim të ngushtë me qendrën e Gestapo-s në Berlin.

Pas kapitullimit të Italisë trupat gjermane pushtuan Shqipërinë, e cila iu nënshtrua të njëjtit fat si edhe vendet e tjera të pushtuara nga Gjermania naziste, ku në rendin e ditës ishin vrasjet e organizuara nga Gestapo-ja.



Skema e Gestapo-s në Shqipëri 1943-1944

Një nga mjetet e para e ushtrimit të terrorit ishin hapjet e kampeve të përqendrimit [Konzentrationslager – KZ], fillimisht në territorin gjerman dhe më vonë dhe në territoret e pushtuara. Autoritetet naziste gjermane krijuan kampe në të gjithë Gjermaninë në baza *ad hoc* për të trajtuar masat e njerëzve të arrestuar si

subversivë të dyshuar. SS -të krijuan kampe më të mëdha në Oranienburg, në veri të Berlinit; Esterwegen, pranë Hamburgut; Dachau, në veriperëndim të Mynihut; dhe Lichtenburg, në Saksoni. Kampet e përqendrimit, ndryshe nga burgjet, ishin të pavarura nga çdo rishikim gjyqësor. Kampet e përqendrimit nazist shërbenin për tre qëllime kryesore:

- Për të burgosur njerëzit të cilët regjimi nazist i konsideronte si një kërcënim për sigurinë. Këta njerëz u burgosën për një kohë të pacaktuar.
- Për të eliminuar individët dhe grupet e vogla, të synuara të individëve me vrasje, larg shqyrtimit publik dhe gjyqësor.
- Për të shfrytëzuar punën e detyruar të popullsisë së burgosur. Ky qëllim u rrit nga mungesa e fuqisë punëtore.

Administrimi i kampeve të përqendrimit ju besua qysh në krye SS-ve [*Schutzstaffel – skuadronet mbrojtëse*], që do të thotë se kampet e përqendrimit ishin krejtësisht jashtë juridiksionit dhe mbikëqyrjes së gjykatave. Kampi i parë i përqendrimit i hapur në Gjermani ishte Kampi i Dachau-t, në Bavari. Komandant i tij u emërua Theodor Eicke (17 tetor 1892 – 26 shkurt 1943), një funksionar i hershëm nazist SS. Organizimi, struktura dhe praktika e zhvilluar në Dachau në 1933–34 u bënë model për sistemin e kampit nazist të përqendrimit ndërsa ai u zgjerua. Ndër praktikantët e hershëm të Eicke në Dachau ishte Rudolf Höss, i cili më vonë komandoi kampin e përqendrimit në Auschwitz.

Shtojca 1: Zhvillimi i mësimit

Tema: SHQIPTARËT NË KAMPIN E PËRQENDRIMIT NAZIST MAUTHAUSEN, AUSTRI

Qëllimi: Nëpërmjet këtij materiali studimor të shoqëruar me pyetje didaktike për zhvillimin e mësimit synohet që nxënësi të marrë dije të mjaftueshme mbi tematikën si edhe të jetë në gjendje të diskutojë për temën.

Metodologjia: Lexim/ punë e pavarur/ diskutim/Ese

Koha: 1 orë mësimore (auditor)

Nr.	Zhvillimi
1	Udhëzo nxënësit të lexojnë pyetjet e përgatitura, në mënyrë që ata të krijojnë një përshtypje të përgjithshme për to.
2	Nxënësit duhet të lexojnë çështjen 1 dhe më pas duhet të flasin për metodat që ndiqeshin për asgjësimin e të burgosurve. Tërhiq vëmendjen për figurën “Shkallët vdekjes” dhe orientoi ata drejt diskutimit.
3	Nxënësit lexojnë rrëfimin e Beqir Xhepës për mbërritjen në kamp. Duke marrë si shembull edhe njohuri të fituara nga dokumentarë ose filma historikë me të njëjtën tematikë, nga kampet e përqendrimit nazist, udhëzo nxënësit të formulojnë shkurt mendimin e tyre mbi këtë çështje.
Ndahet klasa në grupe pune:	
4	<p>Grupi 1: Nxënësit lexojnë pjesën “Barakat” dhe i përgjigjen pyetjeve:</p> <ul style="list-style-type: none">- Çfarë nënkuptonte shënimi <i>“Ka një rrugë për të fituar lirinë. Për të arritur aty duhet bindje, zell, rregull, pastërti, ndershmëri, vetëfljirim dhe dashuri për atdheun.”</i>- Si mendoni, përse ishte shkruar kjo gjë?- Çfarë synohej të arrihej me këtë gjë?

5	<p>Grupi 2: Lexohet pjesa “Përditshmëria në Kamp” dhe “Puna në Kamp” dhe i jepet përgjigje pyetjeve ose flitet për to:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkruaj një ditë pune në kampin e përqendrimit - Çfarë ishte apeli? - Çfarë bënin të burgosurit në kohën e lirë?
6	<p>Grupi 3: Lexoni pjesën “Ushqimi”. A ishte i mjaftueshëm ushqimi? Lexoni menynë ditore që u jepej te burgosurve. Përse ishte e tillë ajo?</p>
7	<p>Grupi 4: Lexoni tekstin dhe shikoni fotot ilustruese në pjesën “Dënimet”. Diskutoni mbi to.</p>
8	<p>Grupi 5: Lexoni pjesën e fundit “Çlirimi”.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përse si mendoni, përse kishte të burgosur që nuk u larguan menjëherë nga kampi? - A keni parë ndonjë film televiziv me subjekt kampet e përqendrimit? Nëse po, gjeni të përbashkëta me çka po lexoni sot? Cilat janë ato?
<p>Prezantimi i rezultateve të grupeve Diskutimi</p>	
9	<p>Lexoni historitë e shqiptarëve që u kthyen gjallë nga Kampi i Përqendrimit Mauthausen.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çfarë ju prek më shumë nga tregimet e tyre? - Cilat janë të përbashkëtat e përjetimeve të tyre? <p>Detyrë shtëpie:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Reflektoni për disa ditë dhe shkruani mendimet tuaja në formën e një eseje të shkurtër mbi tregimet e tyre

Shtojcë 2: Anketë për mësuesit mbi temën e trajtuar

Kjo anketë plotësohet nga mësuesi pas përfundimit të procesit mësimor.

Vendos (x) në shkallën që je dakord.

Pyetjet e anketimit	Shkalla e pëlqimit				
	Shumë dakord (5)	Dakord (4)	Asnjë (3)	Në përgjithësi dakord (2)	Jo dakord (1)
Materiali studimor/ njësia mësimore është përgatitur mirë, mbi bazë logjike dhe e kuptueshme për nxënësin.					
Njësia është e kapshme në përmbajtje dhe jep mesazhe që qarta.					
Njësia thekson krimet e nazizmit dhe pasojat e luftës					
Njësia thekson vlerat e antifashizmit dhe qëndresës ndaj nazizmit.					
Mjetet didaktike të përdorura si materialet filmike, foto etj. më ndihmuan gjatë mësimin					
Shkalla e përdorimit të mjeteve didaktike të ofruara (1= përdorim i kufizuar) (5= ndihmuan shumë)					
Njësia mësimore e pasuroi dijen time profesionale					
Njësia mësimore më ngjalli dëshirën për ta studiuar më shumë këtë temë					
Shkalla e interesit të nxënësve për temën (1= nuk ju pëlqeu) (5= ju pëlqeu)					

Cilat nën çështje të njësisë mësimore duhen trajtuar më gjatë ose më shkurt?

A ju mjaftoi koha për trajtimin e plotë të temës? Çfarë rekomandoni?

Shtojcë 3: Anketë për nxënësit mbi temën e trajtuar

Kjo anketë plotësohet nga nxënësi pas përfundimit të procesit mësimor.

Vendos (x) në shkallën që je dakord.

Pyetjet e anketimit	Shkalla e pëlqimit				
	Shumë dakord (5)	Dakord (4)	Asnjë (3)	Në përgjithësi dakord (2)	Jo dakord (1)
Zgjerova njohuritë e mia për Shqipërinë gjatë Luftës së Dytë Botërore					
Zgjerova njohuritë e mia për krimet e nazizmit gjatë Luftës së Dytë Botërore					
U njoha me sistemin e Kampeve të Përqendrimit naziste gjatë Luftës së Dytë Botërore					
U njoha me vuajtjet e shqiptareve në Kampet e Përqendrimit					
Jam në gjendje të vlerësoj më saktë të kaluarën dhe pasojat e regjimeve totalitare					
Njësia mësimore ishte ndërtuar kuptueshëm dhe me informacion të bollshëm					
Ndihma e mjeteve didaktike (foto, intervista, CD) më ndihmuan për ta përvetësuar temën					
Mësuesi arriti ta përcillte temën mësimore në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme					
Mësuesi që shpjegoi temën mësimore më ngjalli interesin dhe dëshirën të thellohem më shumë në këtë drejtim					

Për cilat nën çështje të trajtuara në këtë njësi mësimore do të kishit dëshirë të mësonit më shumë?

Literatura

- Marenglen Kasmi: Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane në shekullin XX (1900-1945), Tiranë 2020, (Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë).
- Marenglen Kasmi: Pushtimi gjerman i Shqipërisë 1943-1944. Një këndvështrim në dritën e dokumenteve gjermane, Tiranë 2013.
- Dr. Dorian Koçi: "Historia e arrestuarve dhe të mbijetuarve shqiptarë në kampin famëkeq të Mauthausenit në Austri". (CD bashkëngjitur).
- KURZGESCHICHTE DES KZ-MAUTHAUSEN 1938-1945; Materialiensammlung des Mauthausen Komitee
- Offenes Lerneinheit erarbeitet von Mag. Dr. Roland Bernhard Universität Salzburg). Materialien des Dokumentes "Alltag im Konzentrationslager" von Mag. Agnes Stephensen.
- mauthausen-memorial-jahrbuch2007.
- mauthausen-memorial-jahrbuch2021.
- <https://remember.al>
- <https://www.mauthausen-memorial.org>
- CD me materiale

Faqe interneti për të marrë më shumë informacion:

- <https://remember.al>
- <https://www.mauthausen-memorial.org>

